



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 dhjetor 2019
Nr. ref.: RK 1473/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI112/19

Parashtrues

Ilir Kabashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 47/2019,
të 12 marsit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ilir Kabashi, me vendbanim në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Shpend Bokshi, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 47/2019, i 12 marsit 2019 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 3 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi, (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
7. Më 15 korrik 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 7 nëntor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 13 janar 2004, personi SH. M. kishte paraqitur padi për vërtetimin e pronësisë kundër (tani të ndjerit) I. M. në lidhje me: a) ngastrën kadastrale nr. 1865 ZK Prishtinë (ngastra e kontestuar), e cila ishte e evidentuar në emër të parashtruesit të kërkesës; dhe b) ngastrën kadastrale nr. 1867 ZK Prishtinë, e cila ishte e evidentuar në emër të I. V.
10. SH. M. pretendonte se ngastrat e lartcekura, i kishte blerë nga i ndjeri I. M. në vitin 1965. Pasi I. M. kishte vdekur, ishte bërë ndryshimi subjektiv i padisë dhe lidhur me ngastrën kadastrale nr. 1867, si i paditur ishte I. V. i evidentuar si

pronar i kësaj ngastre kadastrale bazuar në kontratën e nënshkruar ndërmjet D. D. si shitës dhe I. V. si blerës, dhe ku SH. M. përmes padisë kërkonte anulimin e kontratës ndërmjet D. D. dhe I. V.

11. Lidhur me ngastrën e kontestuar përmes kësaj kërkesë, e paditur ishte Komuna e Prishtinës, ngase I. M. nuk kishte lënë pasardhës, ndërsa kontrata e nënshkruar ndërmjet D. D. dhe parashtruesit të kërkesës lidhur me ngastrën e kontestuar, ishte shfuqizuar përmes Aktgjykimit të plotfuqishëm të Gjykatës Komunale, P. nr. 1710/2006, të 25 janarit 2007, me arsyetimin se e njëjta ishte bazuar në “dokument të falsifikuar”.
12. Më 22 shkurt 2007, pas kërkesës së SH. M., Gjykata Komunale në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale) përmes Aktvendimit [E. nr. 231/07] caktoi masën e përkohshme: ndalimin e ngarkimit dhe shitjen e ngastrave të cekura më lart.
13. Kundër Aktvendimit [E. nr. 231/07] të Gjykatës Komunale, I. V. kishte ushtruar ankesë.
14. Më 11 shkurt 2008, përsëri Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [E. nr. 231/07] kishte refuzuar ankesën e I. V. dhe kishte vërtetuar Aktvendimin [E. nr. 231/07] të Gjykatës Komunale, të 22 shkurtit 2007, lidhur me masën e përkohshme.
15. Më 5 qershor 2008, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit [C. nr. 35/04] kishte lejuar ndërhyrjen e parashtruesit të kërkesës në anën e palës së paditur, në procedurën lidhur me padinë për ngastrën e kontestuar.
16. Më 29 janar 2009, Gjykata Komunale përmes Aktvendimit kishte revokuar Aktvendimin [C. nr. 35/04] të Gjykatës Komunale, të 5 qershorit 2008, lidhur me lejimin e ndërhyrësit në procedurë të parashtruesit, pasi ai nuk kishte marrë pjesë në seancat gjyqësore lidhur me padinë.
17. Më 29 janar 2009, Gjykata Komunale përmes Aktgjykimit C. nr. 35/2004, kishte aprovuar padinë e Sh. M. për vërtetimin e pronësisë lidhur me ngastrat e cekura më lart.
18. Më 7 prill 2015, Gjykata e Apelit e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), duke vendosur sipas ankesave ndaj Aktgjykimit [C.nr. 35/2004] të Gjykatës Komunale, të 29 janarit 2009, të paraqitura nga paditësi dhe e paditura, përmes Aktvendimit [Ac. nr. 5209/2012] kishte kthyer rastin lidhur me vërtetimin e pronësisë në lidhje me ngastrën e kontestuar në rigjykim dhe rivendosje.
19. Më 3 nëntor 2017, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur propozim në Gjykatën Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme Gjykata Themelore) për anulimin e masës së përkohshme të vendosur me Aktvendimin [E. nr. 231/07] të 22 shkurtit 2007.

20. Më 30 nëntor 2017, Gjykata Themelore, përmes Aktvendimit [C. nr. 929/15], kishte hedhur poshtë propozimin e parashtruesit të kërkesës për anulimin e masës së përkohshme me arsyetimin se ai nuk është palë e autorizuar për të paraqitur propozimin, pasi nuk është palë në procedurën lidhur me padinë, ndërsa statusi i palës ndërhyrëse në procedurë i është revokuar me Aktvendimin e Gjykatës Themelore, të 29 janarit 2009.
21. Ndaj Aktvendimit [C. nr. 929/15] të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkelje esenciale të procedurës kontestimore.
22. Më 14 gusht 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [Ac. nr. 534/18], refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [C. nr. 929/15] të Gjykatës Themelore.
23. Në një datë të pasaktësuar, ndaj Aktvendimit [Ac. nr. 534/18] të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme.
24. Më 12 mars 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktvendimit Rev. nr. 47/2019, hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit kundër Aktvendimit [Ac. nr. 534/18] me arsyetimin se sipas *“[sipas dispozitës së nenit 228 par.1 të LPK-së, palët mund të paraqesin revizion vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë. Duke marrë parasysh këtë, revizioni nuk lejohet kundër aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë, ngase me një vendim të tillë nuk përfundon procedura në formë të prerë. Masa e sigurimit është vendim procedural i cili mund të propozohet para inicimit dhe gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor kontestimore si dhe pas përfundimit të tij, derisa ekzekutimi të përfundojë plotësisht”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjikim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, kur kanë vendosur lidhur me procedurat e gjykatave të rregullta që kanë trajtuar kërkesën e tij për revokimin e masës së përkohshme lidhur me ngastrën e kontestuar.
26. Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se në të gjitha instancat gjyqësore ka kërkuar: a) heqjen e masës së përkohshme; b) t'i lejohet fotokopjimi i dokumenteve; si dhe c) t'i njihet statusi i palës ndërhyrëse në procedurë në mënyrë që të ketë mundësi të mbrojë pronën e tij.
27. Qëndrimi i Gjykatës Supreme, sipas parashtruesit të kërkesës ka sjellur rezultat qartazi arbitrar dhe joracional, sepse parashtruesi është i vetëdijshëm se nuk ka vendim të formës së prerë lidhur me meritat e rastit, por thelbi i çështjes është e drejta e tij për të ndërhyrë në procedurë ku është duke u shqyrtuar çështja e pronës së tij.

28. Ai pretendon se i kishte rikujtuar Gjykatës Supreme edhe të drejtën e tij të garantuar në Kushtetutë sipas nenit 31 dhe nenit 6 të KEDNJ-së, duke u thirrur edhe në rastet e GJEDNJ-së *“Golder Kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Al Dulimi dhe Montana kundër Zvicrës”*. Ai lidhur me këtë thirret edhe në të drejtën për mjete efektive, mohimit të qasjes në gjykatë dhe shkeljes së parimit të barazisë së armëve, duke cituar disa raste të GJEDNJ-së, dhe kërkon nga Gjykata që të fokusohet në çështjen e njohjes së statusit të ndërhyrësit në procedurë.
29. Parashtruesi pretendon se pjesëmarrja e tij në procedurë nuk është vetëm shpresë, por “pritje legjitime” e bazuar në: 1) ligjin vendor; 2) kontratën e shitblerjes; 3) kopjen e planit; dhe 4) Aktvendimin C. nr. 35/04, të 5 qershorit 2008, me të cilin i ishte lejuar ndërhyrja e tij në procedurë.
30. Parashtruesi i kërkesës, më tej, pretendon se aktvendimi me të cilin i është revokuar pjesëmarrja në procedurë për shkak të mospjesëmarrjes së tij në seanca gjyqësore, nuk i është dorëzuar dhe si i tillë ka mbetur vetëm në procesverbal. Për çështje të ngjashme, parashtruesi pretendon se Gjykata ka vendosur në favor të parashtruesit në rastin e Gjykatës Kushtetuese KI108/10, paragrafi 74.
31. Në fund, parashtruesi kërkon që rasti i tij të shpallet i pranueshëm, të konstatohet shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë; të urdhërohen gjykatat e rregullta që parashtruesit t’i lejohet ndërhyrja në procedurë; si dhe të rikthej çështjen e tij për rivendosje në Gjykatën Supreme.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.
33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

34. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit, që përcakton:

Neni 47 i Ligjit
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

35. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 47/2019], të 12 marsit 2019, pasi ka shteruar mjetet juridike të parapara me ligj.
36. Megjithatë, Gjykata shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], respektivisht paragrafin (1) (c) të Rregullores së punës. Ato përcaktojnë si në vijim:

Neni 49 i Ligjit
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

Rregulli 39 i Rregullores së punës
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe [...].”

37. Në lidhje me sa u tha më sipër, Gjykata rikujton se afati 4 (katër) mujor fillon nga *“vendimi i fundit”* në procesin e shterjes së mjeteve juridike me të cilin është refuzuar kërkesa e parashtruesit (shih *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI120/17, parashtrues: *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 30, si dhe rastin e GJEDNJ-së, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, Vendim i 14 marsit 2002).
38. Gjykata rikujton po ashtu se parashtruesi duhet t'i shterojë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë efektive dhe të mjaftueshme. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesi nuk mund të zgjasë afatet kohore strikte të parapara me Ligj dhe Rregullore të punës, duke u përpjekur të ushtrojë mjete juridike që nuk janë të lejuara ose duke u ankuar në institucionet të cilat nuk kanë kompetencë që të ofrojnë mbrojtje të të drejtave

për të cilat ankohet parashtruesi i kërkesës (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese: KI120/17, parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 31, si dhe rastin e GJEDNJ-së, *Fernie kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 14881/04, Vendim i 5 janarit 2006).

39. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se procedura ndaj parashtruesit e zhvilluar para gjykatave të rregullta në lidhje me kërkesën e tij për revokimin e vendimit për masë të përkohshme, ku ishte trajtuar edhe pretendimi i tij lidhur me humbjen e statusit të tij si ndërhyrës në procedurën kontestimore, kishin përfunduar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 534/18] të 14 gushtit 2018, i cili vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore [C. nr. 929/15] të 30 nëntorit 2017, që kishte hedhur poshtë propozimin e parashtruesit të kërkesës për anulimin e masës së përkohshme, me arsyetimin si ai nuk është palë e autorizuar për të paraqitur propozimin e tillë.
40. Në lidhje këtë, Gjykata i referohet Aktvendimit [Rev. nr. 47/2019], të Gjykatës Supreme të 12 marsit 2019, që hodhi poshtë si të palejuar revizionin e parashtruesit kundër Aktvendimit [Ac. nr. 534/18] me arsyetimin se “[sipas dispozitës së nenit 228 par.1 të *Ligjit të Procedurës Kontestimore*] LPK-së, palët mund të paraqesin revizion vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë. Duke marrë parasysh këtë, revizioni nuk lejohet kundër aktvendimit për caktimin e masës së sigurisë, ngase me një vendim të tillë nuk përfundon procedura në formë të prerë. Masa e sigurimit është vendim procedural i cili mund të propozohet para inicimit dhe gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor kontestimore si dhe pas përfundimit të tij, derisa ekzekutimi të përfundojë plotësisht”.
41. Gjykata po ashtu i referohet edhe nenit 228, paragrafi 1, të Ligjit të Procedurës Kontestimore, që përcakton:

“Neni 228
Revizioni kundër aktvendimit

1. Palët mund të paraqesin revizionin vetëm kundër aktvendimeve të formës së prerë me të cilat përfundon procedura e gjykatës së shkallës së dytë ...
[...].”
42. Gjykata rikujton se, në rastin e parashtruesit, pas pranimit të Aktvendimit të Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 534/18] të 14 gushtit 2018, asgjë nuk e ka ndaluar atë t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, ai ka përdorur mjete juridike, si revizionin kundër Aktvendimit [Ac. nr. 534/18], i cili nuk kanë qenë i paraparë me ligj.
43. Rrjedhimisht, si “vendim i fundit”, sipas nenit 49 të Ligjit është Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 534/18], i 14 gushtit 2018, me të cilin ishte refuzuar ankesa e parashtruesit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore [C. nr. 929/15] të 30 nëntorit 2017, dhe i cili ishte përfundimtar dhe i paapelueshëm (shih, *mutatis mutandis*, *Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 46477/99, GJEDNJ, Vendim i 14 marsit 2002).

44. Andaj, Gjykata rikujton se Aktvendimi i Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 534/18], ishte nxjerrë më 14 gusht 2018. Edhe pse parashtruesi nuk ka cekur datën e pranimi të këtij aktvendimi, nga faktet e rastit, është e qartë se koha në mes të pranimi të aktvendimit dhe të datës së dorëzimit të kërkesës së tij, më 2 korrik 2019, në Gjykatën Kushtetuese, ka kaluar periudhën kohore prej 4 (katër) muajsh.
45. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac. nr. 534/18] është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh.
46. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe të parandalohet mbajtja në gjendje pasigurie për një periudhë të gjatë kohore e palëve dhe personave të tjerë të përfshirë në procese gjyqësore (shih, *mutatis mutandis* rastin *Sabri Güneş kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i GJEDNJ-së, i 29 qershorit 2012, paragrafi 39; dhe, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24).
47. Andaj, mbi bazën e arsyetimeve të mësipërme, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit është dorëzuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, të nenit 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, më 7 nëntor 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi